

VENDIM
Nr. 535, datë 13.9.2023

***PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “IMPIANTI I TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA HIMARË
DHE LARGIMI I UJËRAVE TË TRAJTUARA NË DET PËR ITUN HIMARË”***

(Ndryshuar me vendimin nr. 250, datë 24.4.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. *Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura Himarë dhe largimi i ujërave të trajtuara në det për ITUN Himarë”.*

2. *Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Himarë.*

3. *Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “godinë”, “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi, prej 9 047 987.3 (nëntë milionë e dyzet e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë tre) lekësh.*

4. *Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9 047 987.3 (nëntë milionë e dyzet e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë tre) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.*

5. *Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Himarë.¹*

6. *Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.*

7. *Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.*

8. *Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.*

9. *Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Himarë.*

10. *Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Himarë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.*

11. *Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Himarë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.*

¹ *Vendimi nr. 250, datë 24.4.2024 botuar në FZ. nr. 73 datë 26.4.2024 në Kreun 2 të tij shprehet: “Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Himarë”.*

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Himarë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

TABELA E SHPRONËSIMIT, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI
PROJEKTTIT “IMPIANTI I TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA HIMARË DHE LARGIMI I UJËRAVE TË TRAJTUARA NË DET PËR ITUN HIMARË”

NR.	PRONARI			TË DHËNAT KADAISTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)						TRUALL			NDËRTESEË			VLERA TOTALE (lek)	SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)		
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Truall (m ²)	Ndërrësë (m ²)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)				Vlera (lek)
1	Feta Hysenaj			Himarë	1952	1/1799	Godinë	180	180	0	180	4,350	783,000			0	783,000	Depo pikë hapjeje 1763.	Konfirmuar nga ASHK-ja. Sipas raportit të vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social të përgatitur nga ekspert i kontraktuar ka konkluduar se ndërtesa është 100% e amortizuar dhe vlerësimi bëhet vetëm për truall.
VLERA TOTALE																	783,000		

(Shtuar me vendimin nr. 250, datë 24.4.2024)

(i përditësuar)

TABELA E SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTTT “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 535, DATË 13.9.2023, PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTTT ‘IMPIANTI I TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA HIMARË DHE LARGIMI I UJËRAVE TË TRAJTUARA NË DET PËR ITUN HIMARË’”

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)						Të dhënat për shpronësim									Vlera totale (lekë)	Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	"Trulli" (m²)	"Ndërtëse" (m²)	"Trulli"			"Ndërtëse"			Ndërtëse social-ekonomike				
											Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)			Vlera (lekë)
1	Shkëlqim	Qazim	Shytaj	Himarë	1952	1/1952	Trulli + ndërtëse	255	255	85	255.0	4,350.00	1,109,250.00	85.0	58,000.00	4,930,000.00	2,225,737.30	8,264,987.30	Leje legalizimi nr. 213550, datë 22.5.2020. Sip. katit përderis 85 m². Squirit: Vlerësimi i ndërtëses social-ekonomike (struktura ndihmëse) është bërë me situacion punimshëm sipas raportit të vlerësimit.		
Vlera totale																		8,264,987.30			

